



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2915 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

VENDIM

Nr. 21, Datë 29. 02. 2024

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT DHE TË PARASHIKIMIT
AFATMESËM TË TË ARDHURAVE

Mbështetur në

- Ligjin Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
- Ligj Nr 9632 datë 30 10 2006 , “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar
- Ligjin Nr 9920 datë 19.05.2008, “Për Proçedurat Tatimore”, i ndryshuar
- Udhëzim Nr 23 date 30.07.2018 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli i Bashkisë Lezhë**;

VENDOSI:

- I. Të miratojë Raportin e Vlerësimit dhe të Parashikimit Afatmesëm të të Ardhurave për dy vitet e para të vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme, sipas materialit bashkëngjitur.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Kryetari i Bashkisë paraqet Projekt Raportin e vlerësimit dhe të parashikimit afatmesëm të të ardhurave dhe Relacionin bashkangjitur;

Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Lezhë për vitet 2025-2027

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

BURIMET BUXHETORE		2,025	2,026	2,027
		Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	1,125,291	1,138,298	1,161,064
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	653,310	656,976	670,116
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	-	-	-
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	160,650	163,863	167,140
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	122,400	124,848	127,345
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	10,200	10,404	10,612
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	28,050	28,611	29,183
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	51,000	51,020	52,040
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	428,400	428,568	437,139
A.1.5	Taksa e tabelës	10,200	10,404	10,612
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend.	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	3,060	3,121	3,183
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	89,046	90,187	91,991
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	10,200	10,404	10,612

A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	45,900	46,818	47,754
A.2.3	Taksa e rentës minerare	306	312	318
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	32,640	32,653	33,306
A.2.5	Taksa të tjera	-	-	-
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	335,054	342,297	349,143
A.3.1	Tarifa me menaxhimit te mbetjeve	113,420	115,688	118,002
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	46,308	47,234	48,179
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	812	828	845
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	66,300	67,626	68,979
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	36,819	37,555	38,306
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	11,577	11,808	12,044
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	252	257	262
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	24,990	25,490	26,000
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	28,803	29,923	30,521
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	7,140	7,828	7,985
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	243	247	252
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	21,420	21,848	22,285
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	129,862	132,458	135,107
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	-	-	-
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e licensave, lejeve e autorizimeve	10,200	10,404	10,612
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	15,300	15,606	15,918
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licënsimit të veprimtarive të transportit	1,358	1,385	1,413
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licënsuara dhe vendparkime publike	9,164	9,347	9,534
A.3.5.7	Tarifa për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	-	-

A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	510	520	530
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksjat	1,530	1,560	1,591
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	91,800	93,636	95,509
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	-
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	-	-	-
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	15,896	16,214	16,538
A.3.6.1	Bibloteka	66	67	68
A.3.6.2	Muzeumet	1,530	1,560	1,591
A.3.6.3	Teatri	-	-	-
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	10	12	12
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	51	52	53
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	-	-	-
A.3.6.8	Kopshtet	10,200	10,404	10,612
A.3.6.9	Çerdhet	4,039	4,119	4,201
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	-	-	-
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera (Me vendim Këshilli)	10,254	10,459	10,668
A.4	Të Ardhurat e Tjera	47,881	48,838	49,815
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	7,081	7,222	7,366
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik priyat	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-

A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	10,200	10,404	10,612
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-
A.4.10	Trasferata dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	30,600	31,212	31,836
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-
A.4.14	Të tjera	-	-	-

Përmbajtja:

- A. Vlerësimet dhe parashikimi afatmësm i të ardhurave
 - A.1 Të Ardhurat nga Taksat Vendore
 - A.2 Të Ardhurat nga Taksat e Ndara
 - A.3 Të Ardhurat nga Tarifat Vendore
 - A.4 Të ardhura te tjera
- B. Metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave
- C. Analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre egzistuese
- D. Ananliza e risqeve dhe masave për perballimin e tyre

A. Vleresimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave

Te ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të trasfertes nga burimet qëndrore dhe këto burime Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji 139/2015 'Për Qeverisjen Vendore'

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Lezhë e cila përcakton llojet e taksave, bazën e tyre të taksueshme, vlerën e taksueshme, kategorizimin e taksave, lehtësirat fiskale dhe strukturat përgjegjëse për mbledhjen e tyre.

Në hartimin e paketës fiskale janë përfshirë të gjitha drejtorite përgjegjëse për mbledhjen e taksave dhe tarifave, të gjitha njësive administrative, përfaqesuese të biznesit si dhe banor dhe banore të njësive administrative. Diskutimet janë organizuar në njësi administrative si dhe në qytetin e Lezhës. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar dhe janë bërë propozime për ndryshime në paketë për përmirësim, propozime të cilat më pas janë pasqyruar dhe në paketën fiskale të Bashkisë Lezhë.

Paketa fiskale e Bashkisë Lezhë reflekton një politikë thellësisht të qartë për uljen e nivelit të taksave dhe tarifave në kufirin minimal të kornizës ligjore për taksat dhe tarifave. Më poshte disa prej këtyre politikave incentivuese

1. Taksa e ndërtesës për qëllime banimi 30% (pragu maksimal i lejurar) më i ulët nga referenca ligjore
2. Taksa e ndërtesës për biznesin 30% (pragu maksimal i lejurar) më i ulët nga referenca ligjore
3. Taksa e Tokës Bujqësore 30% (pragu maksimal i lejurar) më i ulët nga referenca ligjore
4. Taksë Pasurie zero (Ndërtese, Truall, Tokë Bujqësore) për pensionistët dhe familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike.
5. Taksë Toke Bujqësore zero kur ato mbillen me kultura dru frutorë dhe vreshtari për pesë vitet e para nga casti i mbjelljes.
6. Tarifa vendore zero pensionistët, invalidët, të verberit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, familjet me ndihmë ekonomike, gratë e dhunuara, nënat beqare; gratë kryefamiljare.
7. Kompanitë e transportit publik kur shërbejnë kategorinë e pensionistëve pa bileta transporti
8. Aktivitetet e shërbimit bar kafe kur investojnë në kënd lojërash për fëmijë.
9. Taksa e Ndikimit në Infrastruktura në 1% të vlerës së investimit për ndërtimin e strukturave për përdorim bujqësor e blegtoral që është dhe kufiri minimal ligjor.

Bashkia Lezhë tashmë ka implementuar sistemin e ri të taksave elektronik ku është ndërtuar baza e të dhënave të taksapaguesve biznes dhe po punohet për të updatuar atë të kategorisë familjare. Ky sistem gjithashtu zbaton me përpikëri paketën fiskale të miratuar duke kalkuluar në mënyrë automatike detyrimet vjetore për çdo taksë dhe tarifë dhe u jep mundësi taksapaguesve të regjistrohen në të për të ndërvepruar në kohë reale mbi kërkesë ankesat e tyre, verifikimin e detyrimeve të tyre si dhe kronologjinë e detyrimeve ndër vite dhe pagesat e taksave zë për zë

Planifikimi i të ardhurave

Llojet e taksave dhe tarifave sipas buxhetimit

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore, që vijnë si rezultat i aplikimit të taksave vendore, që vilen nga Njësitet Vendore, përfshihen:

1. Tatimi i Thjeshtuar i Fitimit (Për biznesin e Vogël)
2. Taksa mbi pasurinë;
3. Taksa e tabelës;
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
5. Taksa e Fjetjes në Hotele
6. Taksa të përkohshme

Ndërsa të tjera taksa, që vilen nga Institucionet e treta, sipas buxhetimit quhen taksa te ndara dhe në to përfshihen :

1. Taksa për transferimin e pasurisë së paluejtëshme
2. Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
3. Taksa mbi Rentën Minerare
4. Taksa mbi te Ardhurat Personale
5. Të tjera

Më pas kemi të ardhurat, që vijnë si rezultat i vjeljes së tarifave për shërbimet publike dhe ato administrative, që Njësitë Vendore ofrojnë, ku përfshihen :


1. Tarifa për shërbimet publike, si pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, dekorimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike
2. Tarifa për zënie të hapësirave publike, për qëllime biznesi, etj
3. Tarifa për parkimet e automjeteve
4. Tarifa për certifikimin dhe licencimin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave
5. Tarifa për paisje me licencë për tregëtimin e lëndëve djegëse, hidrokarbure
6. Tarifa e Shërbimeve nga Drejtoria e Palniikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban
7. Tarifa për shfrytëzim të ambjenteve të Institucioneve vartëse
8. Tarifa për shërbimin e akomodimit dhe ofrimit të ushqimit ndaj fëmijëve në Kopështe dhe Cerdhe
9. Tarifa për përdorimin e mjeteve të lundrimit

Pjesë e të ardhurave, janë edhe grante nga ndihma nderkombetare, qera nga asete të bashkise, janë edhe penalitetet të cilat aplikohen në rastet e moszbatimit të rregullave në zbatimin e ligjit në fuqi dhe përfitimin e shërbimeve publike e të tjera

Te ardhurat e veta sipas viteve

Te ardhurat e veta që parashikohen të mbledhen nga nga Bashkia Lezhe kanë të njëjtin trend rrites për tre vitet e ardhshme


	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
Te Ardhurat e Veta	438 851	593 853	1 105 724	1 125 291	1 138 298	1 161 063
Taksat Vendore	138 198	260 586	640 500	653 310	656 976	670 115
Taksat e Ndara	76 489	86 125	83 700	89 046	90 187	91 990
Tarifat Vendore	206 779	247 142	330 981	335 054	342 297	349 142
Te Tjera	17 386	12 577	46 943	47 881	48 838	49 814



A.1 Te Ardhura nga Taksat Vendore

Per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese parashikohet qe te ardhurat nga taksat vendore te perbejne 58% te te ardhurave nga burimet e veta

<i>Te ardhura ne 000 leke</i>	<i>Viti 2024</i>	<i>Viti 2025</i>	<i>Viti 2026</i>	<i>Viti 2027</i>
<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>	640 500	653 310	656 976	670 115
<i>Taksa Biznes i Vogel (prapambetur)</i>	-	-	-	-
<i>Taksa e Pasurise</i>	157 500	160 650	163 863	167 140
<i>Taksa e Nderteses</i>	120 000	122 400	124 848	127 344
<i>Taksa e Truallit</i>	27 500	28 050	28 611	29 183
<i>Taksa e Tokes Bujqesore</i>	10 000	10 200	10 404	10 612
<i>Taksa e fjetjes</i>	50 000	51 000	51 020	52 040
<i>Taksa e Infrastruktures</i>	420 000	428 400	428 568	437139
<i>Taksa e Tabeles dhe Reklames</i>	10 000	10 200	10 404	10 612
<i>Taksa e Perkoshme</i>	3 000	3 060	3 121	3 183



Per Taksat Vendore parashikimi sipas llojit te taksave per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese me te njejtin trend rrites kane kete rendesi ne perqindjen e mbaledhjes se ardhurave:

Taksa e Infrastruktures 66% te totalit

Taksa e Nderteses 19% te totalit

Taksa e Truallit 4%

Taksa e Tokes Bujqesore 1%

Taksa e Fjetjes 8%

Taksa e Tabeles dhe Reklames 2%

1. Tatim mbi fitimin e thjeshtuar te biznesit te vogel. Kjo takse mblidhet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe e cila mban ne rolin e agjentit tatimor 1% te vleres totale te kesaj takse
2. Taksa e Pasurise e perbere nga Taksa e Nderteses, Taksa e Truallit dhe Taksa e Tokes Bujqesore ze rreth 24% te te ardhurave nga taksat vendore. Kjo takse eshte parashikuar mbi bazen e kapacitetit fiskal mesatar dhe do te mblidhet duke zgjeruar bazen e taksapaguasve dhe duke saktësuar siperfaqet nepermjet, vetedeklarimit te pasurise si nga kategoria biznes si nga familjaret, grupeve te punes te perbera nga specialiste te drejtorise se taskave dhe punonjes te njesive administrative, agjentit tatimor UK Lezhe, Ashk, si dhe Kadastres Fiskale ne Ministrine e Fizncave, si dhe duke mbajtur ne pragun minimal te lejuar nga ligji nivelin e taksimit.

3. Taksa e Fjetjes ze rreth 8% te te ardhurave nga taksat vendore, parshikohet sipas kapacitetit te strukturave hoteliere dhe ne baze te gjykimit te eksperiences se specialisteve te terrenit te drejtorise se taksave. Gjithashtu rritja parshikohet te kryhet dhe nepermjet implementimit te ligjit te ri per Turizmin ku administrata bashkiake do te kete akses ne regjistrin e statistikave te parashikuar ne ligj nga Ministria e Turizmit si dhe nga kontrolllet ne terren nga specialistet e drjetorise se taksave.
4. Taska e Infrastruktures ze rreth 66% te te ardhurave nga taksat vendore dhe parashikohet te kete leje zhvillimore kryesisht ne sektorin e Turizmit per tre vitet ne vijim
5. Taksa e Tabeles dhe Reklames ze rreth 2% te te ardhurave vendore te parashikuara dhe kjo takse do mblidhet nepermjet kotrolleve te vazhdueshme nga struktura e drejtorise se taksave ne terren

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme e cila bazohet ne subjektet qe operojne ne Bashkine e Lezhes, te cilet ne menyre te permbledhur jane si vijon:

1. Taksapagues Biznes I Madh: 948 nga keto me status aktiv 607, pezulluar 238, pasiv 101.
2. Taksapagues Biznes I Vogel: 4195 nga keto me status aktiv 2551, pezulluar 1160, pasiv 450
3. Taksapagues Pronare (pronarët e pasurive që kanë dhënë ambientet me qera subjekteve biznes) 340.
4. Taksapagues Istitucione 22.
5. Taksapagues Familjare: 33 088 nga keto 7 985 familje te perjashtuara per ndihme ekonomik, pensionista etj, 16 809 familjare abonente pran eagentit tatimor UK Lezh edhe 8 294 familjare qe ndiqen nga njesite administrative.

Arsyeja e parashikimit per secilen takse eshte si me poshte:

a) Taksa e Pasurise

1. Taksa mbi Ndërtesat – Sasia e M2 te fiskalizuar parashikohet te rritet me te pakten 10% ne tre vitet e ardhshme. Kjo do te arrihet me rritjen e numrit te kontrollleve ne terren, te cilat do te mundesojne rritjen e fiskalizimit te subjekteve qe deklarojne pasurine e paluajtshme qe kane ne pronesi apo ne perdorim, duke rritur keshtu bazen e taksueshme me 3% cdo vit.

2. Taksa mbi Truallin – Do te bashkepunohet me ASHK dhe te gjitha subjektet e tjera pergjegjese per fiskalizimin e subjekteve qe kane ne perdorim truall per qellime biznesi. Gjithashtu kjo takse do te jete ne fokus te Sektorit te kontrollit ne Terren per identifikimin e ketyre subjekteve. Ne kete menyre baza e taksueshme pritet te rritet dhe vlere e parashikuar per arketim nga kjo takse planifikohet te rritet me 3%.

3. Taksa mbi Tokën Bujqësore – Ne bashkepunim me Njesite Bashkiake, do te ngrihen grupe pune per kontrollin ne terren dhe fiskalizimin e te gjitha subjekteve biznes dhe sidomos familjare ne keto zona per deklarimin e pasurise. Kjo do te ndokoje ne rritjen e bazes se taksueshme me 25%-30% te Takse mbi token bujqesore.

b) Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja do te kete nje rritje prej 3% ne vitin 2024 krahasuar ne 1 vit me perpara. Kjo rritje do te jete 5% ne 2025 dhe 8% ne 2026 krahasuar me 2023

c) Taksa Vendore mbi Veprimtarinë e Shërbimit Hotelier – Sherbimi hotelier do te kete nje vemendje maksimale ne 3 vitet e ardhshme. Per kete arsye do te jete ne fokusin e grupeve te inspektimit ne terren per sakesimin e numrit te dhomave dhe numrit te shtreterve qe pritet te kene nje rritje me 25%. Gjithashtu do te jete ne fokus per identifikimin dhe fiskalizimin e subjekteve te reja dhe te deklarimit te sakte te neteve te fjetjes. Kjo vlere ne 2024 parashikohet te jete 51.250.000 leke te reja, me nje rritje mesatarisht 3% ne vitet pasardhese.

ç) Taksa e Tabelës parashikohet te mblidhet ne shifren 10.250.000 leke ne vitin 2024 duke u fokusuar ne kontrollin ne terren te subjekteve dhe ne faturimin sipas Paketes Fiskale ne fuqi te tabelave reklamuese dhe atyre informuese. Tabelat informuese do te rriten ne 50% ne sasine e m2 te fiskalizuar, ndersa Tabelat reklamuese planifikohet te rriten me 10% te mases se fiskalizuar deri ne vitin aktual.


d) Taksa e Përkohshme per Shtresat ne Nevoje, e cila eshte perfshire ne Pakete Fiskale 2023, do te vazhdoje te mblidhet edhe ne periudhen 2024-2026. Kjo takse do ti mblidhet te gjitha Bizneseve te Medha

qe operojne ne Bashkine Lezhe dhe per 2024 parashikohet te mblidhet ne vleren 5.125.000 leke, te cilat parashikohet te jene ne numrin 1025 subjekte biznes i madh aktive te taksueshme.

A.2 Te Ardhurat Nga Taksat e Ndara

Per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese parashikohet qe te ardhurat nga taksat e ndara te perbejne 8% te te ardhurave nga burimet e veta

<i>Te ardhura ne 000 leke</i>	<i>Viti 2024</i>	<i>Viti 2025</i>	<i>Viti 2026</i>	<i>Viti 2027</i>
<i>Te ardhura nga taksat e Ndara</i>	87 300	89 046	90 187	91 990
<i>Taksa e kalimit te Pronesise se Paluajtshme</i>	10 000	10 200	10 404	10 612
<i>Taksa e Regjistrimit te Automjeteve</i>	45 000	45 900	46 818	47 754
<i>Taksa e Rentes Minerare</i>	300	306	312	318
<i>Tatim Mbi te Ardhurat Personale</i>	32 000	32 640	32 653	33 306
<i>Te tjera</i>	-	-	-	-




1. Te Ardhura nga Taksa e Kalimit te Pronesise se Paluajtshme ze rreth 11% te taksave te ndara per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese duke u bazuar nga te dhenat nga agjenti tatimor dhe eksperiencen e ketyre te ardhurave nder vite.
2. Taksa e Regjistrimit te Automjeteve ze rreth 52% te taksave te ndara per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese duke u bazuar ne numrin e automjeteve dhe eksperiencen e arketimeve nga agjenti tatimor nder vite.
3. Tatim Mbi te Ardhurat Personale ze rreth 37% te taksave te ndara per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese duke u bazuar ne raportet dhe arketimet nder vite nga drejtoria rajonale tatimore si dhe implementimin e ndryshimeve ligjore per vitet ne vijim.
4. Taksa Mbi Renten Minerare i referohet realizimit te te ardhurave nder vite.

A.3 Te Ardhurat Nga Tarifat Vendore

Per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese parashikohet qe te ardhurat nga tarifat vendore te perbejne 30% te te ardhurave nga burimet e veta

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Bashkrite krijojnë te ardhura; nga shërbimet publike qe ato ofrojnë, dhenie leje, autorizime e licenca, aktivitete etj, sipas legjislacionit ne fuqi.

<i>Te ardhura ne 000 leke</i>	<i>Viti 2024</i>	<i>Viti 2025</i>	<i>Viti 2026</i>	<i>Viti 2027</i>
Te ardhura nga Tarifat Vendore	330 981	335 054	342 297	
Tarifa e Pastrimit te Mbetjeve	111 197	113 420	115 688	118 001
Tarifa e Ndrimit Publik	36 098	36 819	37 555	38 306
Tarifa e Gjellberimit	30 739	28 803	29 923	30 521
Tarifa (leje, licenca, autorizime)	10 000	10 200	10 404	10 612
Tarifa Parkimi	8 985	9 164	9 347	9 533
Tarife Per Kulturen	1 625	1 657	1 681	1 714
Tarife per Hapesiren Publike	90 000	91 800	93 636	95 568
Tarifa e Urbanistikes	15 000	15 300	15 606	15 918
Tarifa MZSH	1 500	1 530	1 560	1 591
Tarifa Leje Trasporti	1 332	1 358	1 385	1 412
Tarifa Lende Drusore	500	510	520	530
Pagesa Cerdhet	3 960	4 039	4 119	4 201
Pagesa Kopshtet	10 000	10 200	10 404	10 612
Tarifa te Tjera	10 045	10 254	10 459	10 668



1. Tarifat e Sherbimit Publik (Pastrim, Ndricim, Gjelberim, Dekor) zene rreth 54% te te ardhurave nga tarifat vendore per vitin 2024 dhe tre vitet ne vijim. Parashikimi i tyre eshte bere ne kapacitetin aktual te numrit te bizneseve, llojit te tyre dhe qarkullimit vjetor te tyre , numrit te familjareve dhe institucioneve, rritjen e ketij kapaciteti nepermjet shtimit te bazes se taskapaguesve fale politikave lehtesuese per familjaret dhe kategori te vecanta biznesi.
2. Tarifa per Leje Licenca e Autorizime zene rreth 3% te te ardhurave nag tarifat vendore per vitin 2024 dhe tre vitet ne vijim. Parashikimi i tyre eshte bere duke analizuar numrin e aplikimeve nder vite pe rinovim si dhe kerkesat e reja per ushtrime aktiviteti ku percaktohen llojet e tyre per leje, license dhe autorizim sipas ligjit.
3. Tarifa e Parkimit ze rreth 3% te te ardhurave nga tarifat vendore per vitin 2024 dhe tre vitet ne vijim dhe eshte perlllogaritur ne baze te arketimeve nder vite.
4. Tarifa per Kulturen ze rreth 1% te te ardhurave nga tarifat vendore dhe eshte perlllogaritur nga kapacitetet e Drejtorise se Kultures dhe monumenteve ne varesi te saj si dhe arketimet nder vite.
5. Tarifa per Hapesirat Publike ze rreth 27% te te ardhurave nga tarifat vendore per vitin 2024 dhe tre vitet ne vijim. Perlllogaritja eshte bere nga nga numri i stacioneve te plazhit te rregulluar me VKM perkatese ne bashkepunim me Agjensine e Bregdetit si dhe numrit te kerkesave te reja qe aplikohen cdo vit
6. Tarifa e Urbanistikes ze rreth 5% te te ardhurave nga tarifat vendore dhe eshte perlllogaritur duke patur parysh numrin mesatar te kerkesave te qyetetareve prane Drejtorise se Urbansitikes dhe arketimeve nder vite
7. Pagesat nag Kopshtet dhe Cerdhet ze rreth 1% te te ardhurave nga tarifat vendore per vitin 2024 dhe parashikimi eshte bere mbi bazen e kapaciteteve nga keto institucione si dhe numri i femijeve qe sherbehen ne to.

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

1) Tarifa e Sherbimi e Publik – Kjo Tarife perbehet nga 4 Tarifa, te cilat ndikojne ne totalin e kesaj takse si vijon :

- a) Tarifa pastrimit – 55% e totalit
- b) Tarifa për ndriçim publik – 22% e totalit
- c) Tarifë për gjelbërimin – 21% e totalit
- d) Tarifë për dekor – 1% e totalit

Parashikohet qe kjo Tarife te mblidhet ne vleren 505.456.000 per tre vitet e ardhshme, me nje rritje mesatare 3% nga viti ne vit (Vlerat nominale per cdo takse/vit jane te percaktuuar ne tabele). Kjo tarife u faturohet Bizneseve, Familjareve dhe Institucioneve, peshen kryesore e te ciles e mban Biznesi (68%) familjaret 31% dhe 1% Insitucionet. DTTV do te punoje ne bashkepunim me UKL dhe Njesite Administrative per krijimin e regjistrit te plote te Familjareve qe do te ndikojte drejtperdrejt ne mbledhjen e tarifave te tyre ne masen +15% te bazes se taksueshme.

2) Tarifa për Zënien dhe Përdorimin e Hapësirës Publike Plazhe dhe Biznes– parashikohet te mblidhen ne vleren 315.650.000 leke ne tre vitet e ardhshme. Ne mase te konsiderueshme kjo vlere perbehet nga Hapesirat Publike qe shfrytezohen per Plazhe e Shezllone (246.795 m), ne zonat bregdetare, dhe gjithashtu nga Hapesirat publike, qe perdoren per biznes ne te gjithë territorin e bashkise. DTTV do te vazhdoje kontrollin ne terren per verifikimin e te gjithë subjekteve qe operojne ne zonat bregdetare ne bashkine Lezhe. Gjithashtu eshte ne fokus verifikimi dhe faturimi i te gjithë subjekteve qe shfrytezojne hapesisrat publike per qellime biznesi jashte zonave bregdetare. Rritja e nivelit te tarife me 33% ne vitin 2023, ndikoi ndjeshem ne rritje e vleres se kesaj tarife. Ne 2024 situata pritet te rritet me 15% ne M2, duke cuar ne rritje te vleres se tarifes me 3%


3) Tarifa për Shërbimet Administrative dhe Dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve – 83.412.000 leke eshte vlere e parashikuar te mblidhet 3 vitet e ardhshme nga kjo vjelja e kesaj tarife. Tarifë për leje, liçenca dhe autorizime dhe Tarifë për zhvillim dhe kontroll territori mbajne peshen kryerose ne Sherbimet Administrative me nje vlere te parashikuar prej 74.020.000 leke, ose 88% te totalit te parashikuar.

4) Tarifa për shërbimet e tjera sociale – burimi i se ciles jane Biblioteka, Muzeu, Sporti , Konvikti, Kopshte, Çerdhe dhe Qendra Kulturore e Fëmijë jane parahikuar te mblidhen rreth 48.519.000 leke ne tre vitet e ardhshme, me nje rritje mesatarisht 5% dhe 8% nga viti 2023. Peshen kryesore Kopshtet, Cerdhet dhe Muzeu. Kjo rritje i atashohet rritjes me 35% te numrit te turistev qe vizitojne Muzeun dhe rritjes me 5% te numrit te femijeve te regjistruar ne Kopshte e Cerdhe.

A.4 Te Ardhura te Tjera

Per vitin 2024 dhe tre vitet pasardhese parashikohet qe te ardhurat nga te ardhura te tjera te perbejne 4% te te ardhurave nga burimet e veta

Te ardhura ne 000 leke	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
Te ardhura te tjera	46 943	47 881	48 838	49 814
Donacione e te ngjashme	30 000	30 600	31 212	31 836
Qera asete etj	6 943	7 081	7 222	7 366
Gjoba tatimore e penalitete	10 000	10 200	10 404	10 612
Te tjera	-	-	-	-



1. Donacione e grante perbejne rreth 64% te te ardhurave te tjera te parashikuara per vitin 2024 dhe tre vitet ne vijim jane parashikuar mbi marreveshje me Organizata te Ndryshme Joqeveritare kombetare e te Huaja dhe projekte mundesisht fituese qe jane paraqitur nga Bashkia Lezhë pranë institucioneve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare donatore ne fusha tëndryshme.
2. Gjoba e Penalitete përbejnë rreth 21% të të ardhurave të tjera të parshikuara për vitin 2024 dhe tre vitet në vijim. Ky zë është përlloragitur nga kamat vonesat e mospagimit në afat të detyrimeve si dhe numrit mesatar ndër vitë të sanksioneve të mbajtura nga specilaistët e taskave dhe të policise bashkiake.
3. Qeraja nga Asetet zë rreth 15% të të ardhurave të tjera për vitin 2024 dhe tre vitet në vijim, janë përlloragitur në bazë të kontratave vijuese mes Bashkisë Lezhë sipas vendimeve të këshillit bashkiak

B. Metodologjia e perdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave.

Drejtoria e Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Sherbimeve Publike, e Urbanistikës, e Fiancës, e Projekteve Strategjike, Kulturës si dhe të gjithë drejtoritë e tjera në bashki, me përfshirjen e agjenteve tatimore UK Lezhë, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, dhe me Kryetarët e Njësive Administartive; për parashikimin e të ardhurave afatmesme është bazuar mbi baza të thjeshta me tregues të njohur si numri i popullsisë, numri i familjeve, numri i bizneseve të analizuara sipas treguesve në dispozicion dhe kategorizimeve të tyre. Gjithashtu herë pas here për zera te vecante sic e trajtuam dhe me lart parashikimet janë bërë mbi analizen e gjykimit profesional të specilaisteve të drejtorive pjesemarrëse dhe statistikave të arkëtimeve ndër vite.

C. Analiza e efekteve te politikave te reja fiskale ose te ndryshimit te atyre egzistuese

Dashkia Lezhe nder vite ka vazhduar me permiresimin teknik te paketes fiskale per te rritur cilesine e sherbimeve ndaj taksapaguesve me investimin ne sistemin elektronik te taksave dhe me politiken e saj lehtesuese ku mbizotojne lehtesimet fiskale per taksapguesit familjare si me siper jane renditur si dhe kategori te vecanta biznesi.

D. Analiza e risqeve dhe masave per perballimin e tyre

Menaxhimi i Riskut eshte nje element thelbesor per organizimin menaxherial, planifikim e te ardhurave, raportimin dhe kontrollin e financave i rregulluar me ligj.

Menaxhimi i Riskut permban, Identifikimin e Objektivave, i Risqeve te Jashtme dhe te brendshme, Analiza e vleresimi i secilit risk, Marrja e masave te metejshme per reduktimin ose eliminimin e tij, Paraqitja e konkluzioneve te arritura, Monitorimi i Riskut dhe Plani i Veprimit

Per realizimin e te ardhurave te veta me poshte tabela e risqeve

n r	Pershkrimi i Riskut	Risku fillestar	Masat ekzistuese	Risku pas masave	Nevoja per masa te metesjhme	Planifikim per reduktim te Riskut	Struktura pergjegjese	Eficienta e rezultati
1	Mangesi informacioni ASHK	I Larte	Kerkese per baze te dhenash ne menyre zyrtare	I larte	po	Kerkese prane ASHK qendrore	Kryetari i Bashkise	Permiresuar
2	Mangesi informacioni QKB	Mesem	Shkembim informacioni mujor	I ulet	po	Krijimi i nderfaqes mes sitemit te taskave dhe QKB	Bashkia	Permiresuar
3	Mangesi kredenciale zyrtare prane AKSHIT	I Larte	Kerkese per kredencial e zyrtare nga Kryetari i Bashkise	I larte	po	Kerkese prane ministrise se linjes	Bashkia	Pandryshuar
4	Dixhitalizimi i sistemit per kategorie biznes	I Larte	Implemntimi i sistemit	I ulet	po	Rakordim i shpejt e i pagesave	Bashkia	permiresuar
5	Dixhitalizimi i sistemit per kategorie familjare	I larte	Updatimi i te dhenave mbi pasurine	I larte	po	Bashkepuni m ASHK, UKL, Njesi amdinistrative	Drejtoria e taksave	permiresuar
6	Mangesi informacioni nga Drejtoria Rajonale tatimore	I ulet	Rakordim dhe raportim periodik	I ulet	jo		Drejtoria e taksave	permiresuar
7	Ndjekja e masave shternguese	I larte	Zbatimi i udhezimit te ministrit	I mesem	po	Kerkese ministrise se linjes per	Spektori i borxhit Drejtoria e	permiresuar

		te financave dhe ministrin te brendshem			kredenciale zyrtare prane AKSH	taksave dhe Tarifave vendore	
8	Sherbimi me I larte taksapaguesin	I larte	Njoftim detyrimi dhe njoftim vleresimi i detyrimeve tatimore	I mesem po	Fushata me njoftime publike per regjistrimin e taksapaguesve ne sistemin e taksave me kredenciale te tyre	Bashkia	permiresuar
9	Plotesim dokumentacioni dosje	I mesem	Vetedeklarim dhe kontrolle ne terren pe rbizneset	I mesem Po	Kontrolle ne terren	Spektori Terrenit drejtoria e taskave	permiresuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 216/ Prot.
22

Lezhë, më 11.03.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" të ndryshuar, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të përgaditjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.21, datë 29.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe të parashikimit afatmesëm të të ardhurave".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

